# DËSHMI ARKIVI

**A-472485**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Rama nga New York: Projekti i Sazanit dhe Zvërnecit, të jashtëzakonshëm për ekonominë shqiptare! - Informohu siç duhet |
| ADRESA | `https://radar.al/rama-nga-new-york-projekti-i-sazanit-dhe-zvernecit-te-jashtezakonshem-per-ekonomine-shqiptare/` |
| BURIMI | radar.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 26 shtator 2026, 19:20:27 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 26 shtator 2026, 19:09:41 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | 0b10117ebd24467d8f0bbddd8c287c438bfad0cf50c3b6e30f52470a265107fe |
| TEKSTI | 32a16491d131f1ad4ea2c356035e515cbf233e1022fb94cf3b5b738518fb20f7 |
| PAMJA | 8a12a4d09e4e67e5805b3cad05150a259df067b09ea21f30bbf3b8f4f9213525 |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | d9e5b822225b79ae7ceea95f3243bcd9720f320e191a742bc2d1f653f7dd2332 |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | bdb0f4977024bde548b4e3b2f30b00cf48adba46ab69ac7a79901c9e1751e8c0 |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/d9e5b822225b79ae7ceea95f3243bcd9720f320e191a742bc2d1f653f7dd2332`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

KRYESORE

# Rama nga New York: Projekti i Sazanit dhe Zvërnecit, të jashtëzakonshëm për ekonominë shqiptare!

SEPTEMBER 26, 2026



Kryeministri Edi Rama ka zhvilluar ditën e sotme një takim me komunitetin shqiptar në Staten Island, New Jork.

Gjatë fjalës së tij para të pranishmëve, Rama tha se Shqipëria po synon turizmin e vlerës, me qëllim sjelljen e më shumë përfitimeve ekonomike për popullin shqiptar.

Rama përmendi edhe investimet që pritet të realizohen në ishullin e Sazanit dhe në Zvërnec të Vlorës, ku tha se vetëm në Zvërnec do të investohen 4 miliardë euro, një shumë që sipas kryeministrit është tepër e lartë për ekonominë shqiptare.

Ai shtoi se Qeveria po studion edhe dëmin që këto projekte mund të sjellin në mjedis, duke hartuar një studim të plotë mbi risqet reale.

"Këtë synim ka projekti i shumëdiskutuar, projekti i famshëm, por edhe fatkeq për fat të keq, si rezultat i shumë gënjeshtrave, manipulimeve, denigrimeve. Projekti i Sazanit dhe Zvërnecit, një projekt që sjell vetëm në Zvërnec më shumë se 4 miliardë euro, në një ekonomi që në totalin e vet është 27 miliardë euro. Një projekt i jashtëzakonshëm për Shqipërinë. Është jashtëzakonisht delikat edhe në aspektin e ekuilibrit për mjedisin, prandaj ne po punojmë shumë për të pasur një studim për ndikimin dhe risqet në mjedis. Risqet reale dhe jo ato që prodhohen në rrjetet sociale nga sharlatanët e manipulatorët. Shpresoj që kur të vini në Shqipëri, kryepolici të na japë mundësi që të takohemi. Para se të vija këtu, më mori në telefon Dritani nga Mali i Zi, ish-kryeministri dhe miku im i shtrenjtë, i vetmi qytetar i botës në Ballkan, i cili më tha 'shiko se atje ku po shkon, te ajo dallga shqiptare, ke edhe disa shkumë nga Ulqini. Kështu që shumë faleminderit", tha mes të tjerash Rama.

aktualitet | diaspora | Edi rama | ekonomi | ekonomi shqiptare | investime | investime strategjike | ishulli i Sazanit | komuniteti shqiptar | lajme | New York | projekti i Sazanit | projekti i Zvërnecit | Qeveria shqiptare | rama | Riviera shqiptare | Sazan | shqipëri | turizëm | turizmi në Shqipëri | Vlorë | zhvillim ekonomik | Zvërnec

SHARE.

Demo

## Postimet e reja

"Marre ju qoftë", motra e Gjestit revoltohet ndaj...
SEPTEMBER 26, 2026

Rama nga New York: Projekti i Sazanit dhe...
SEPTEMBER 26, 2026

Shqipëria e 8-ta në botë për importet e dronëve...
SEPTEMBER 26, 2026

Rama takim me komunitetin shqiptar në...
SEPTEMBER 26, 2026

## Mos e humb

FOKUS | SEPTEMBER 24, 2026

Dosja/ Biznesmeni Meqemeja i dha Ahmetajt 140 mijë euro! SPAK: Shpërblim për Inceneratorin e Fierit përmes shitjeve fiktive

Biznesmeni Sokol Meqemeja njihet si pronar i disa kompanive apo sipërmarrjeve. Përveç 'Delvina Gas' ai...

ALERT në Slloveni për VIPA Flips të Kosovës, kanë përmbajtje të alergjenësh. Produkti hiqet nga tregu

Kreditorët te dera, gjykata në kërkim të "Top Fruits" të Ejup Ahmetit dhe Marin Gjonajt: Paraqituni në gjyq

Kompania e krijuar tri ditë pas hapjes së thirrjes për grantet e startupeve fitoi 6.1 milionë lekë në fazën e rezervuar për biznese të paktën 1-vjeçare

## Na ndiq




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.